



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

## Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 16.06.2022

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 14.06.2022, të parashtruar nga Operatori Ekonomik **Roza Komani B.I.**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i objektit të banimit social - Kontratë dy vjeçare “ , **Nr. i prokurimit-632-22-5053-5-2-1**, nxjerr:

### V E N D I M

- 1. Aprovohet si pjesërisht e bazuar** kërkesa për ri-shqyrtim të Operatorit ekonomik: Operatorit Ekonomik **Roza Komani B.I.**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i objektit të banimit social - Kontratë dy vjeçare “ , **Nr. i prokurimit- 632-22-5053-5-2-1** kundër Dosjes së tenderit dhe Njoftimit për kontratë te AK –së, të datës 18.05.2022, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
- 2. Përmirësohet DOSJA E TENDERIT DHE NJOFTIMI PËR KONTRATË , i publikuar me datë: 02.06.2022;**
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të bëjë përmirësimin e Dosjes së tenderit dhe Njoftimit për kontratë.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

## Ar sy e t i m

Operatori Ekonomik **Roza Komani B.I.**, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim , lidhur me aktivitetin e prokurimit ““Ndërtimi i objektit të banimit social - Kontratë dy vjeçare “ , Nr. **i prokurimit- 632-22-5053-5-2-1,**

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 16.06.2022, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pas shqyrtimit të Kërkesës për rishqyrtim të Operatorit Ekonomik **Roza Komani B.I.** , të **dt.14.06.2022**, Autoriteti kontraktues, konstaton se pretendimet e Operatorit në fjalë, janë pjesërisht të bazuara, prandaj vendos që të bëj përmirësimin e dosjes së tenderit dhe Njoftimit për kontratë.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

### **Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

**z.Faton Gutaj**

**Menaxher i Zyrës së Prokurimit**

**Kopje:** Operatorit Ekonomik;  
Zyrës së Kryetarit te Komunës;  
Te gjitha palëve te interesuara;

